



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr.1119/4prot

Datë 04.07.2023

V E N D I M

K.P.P. 552/2023

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Jonaid Myzyri	Kryetar
Fiorent Zguro	Nënkryetar
Anila Malaj	Anëtar
Kreshnik Ternova	Anëtar

Në mbledhjen e datës 04.07.2023 shqyrtoi ankesën me:

Objekt:

Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për skualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik “Power Industries” SHPK në procedurën e prokurimit “*Procedurë e hapur*”, me Nr. REF-58081-02-06-2023, me objekt: “*Blerje Kazane për mbetje urbane*” me fond limit 29.869.700 (Njëzet e nëntë milion e tetëqind e gjashtëdhjetë e nëntë mijë e shtatëqind) lekë pa TVSH, zhvilluar me datë 01.03.2023 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Durrës

Ankimues:

“Power Industries” SHPK
Vorë, Picar, Tiranë

Autoriteti Kontraktor:

Bashkia Durrës
Sheshi “Liria”, Qyteti Durrës

Baza Ligjore:

Ligji nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766/2021, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik” .

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoji relatorin e çështjes, shqyrtoi parashtrimet me shkrim të ankimuesit, dokumentacionin e paraqitur nga autoriteti, pretendimet e ankimuesit, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

Vëren:**I***Vlerësimi paraprak*

I.1. Vlera limit e përlogaritur për procedurën e prokurimit objekt-ankimi është mbi kufirin e ulët monetar, ndaj shqyrtimi dhe vendimmarrja do të bëhet nga të gjithë anëtarët, në përputhje me pikën 1, të nenit 30 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”.

I.2. Operatori ekonomik ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të.

I.3. Operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”.

I.4. Ankimuesi ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

II*Rrethanat e çështjes*

II.1. Në datën 07.02.2023 në Sistemin e Prokurimeve Elektronike, është publikuar procedura e prokurimit “Procedurë e hapur”, me Nr. REF-58081-02-06-2023 me objekt “Blerje Kazane për mbetje urbane” me fond limit: 29.869.700 (Njëzet e nëntë milion e tetëqind e gjashtëdhjetë e nëntë mijë e shtatëqind) lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 01.03.2023 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Durrës.

II.2. Në datën 01.03.2023, autoriteti kontraktor ka zhvilluar procedurën e prokurimit.

II.3. Në datën 13.03.2023 operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurën e prokurimit janë njoftuar elektronikisht mbi klasifikimin përfundimtar të ofertave për vlerat pa TVSH si më poshtë:

1. “Leon Konstruksion” SHPK 22 750 000 lekë skualifikuar
2. “Zeqiri” SHPK 26 397 000 lekë kualifikuar
3. “Power Industries” SHPK 28 980 000 lekë kualifikuar
4. “Vibtis” 29 620 500 lekë skualifikuar

II.4. Nga verifikimet në Sistemin e Prokurimeve Elektronike rezulton, se më datë 20.03.2023 është publikuar Njoftimi i Fituesit paraparak për procedurën e prokurimit objekt-ankimi.

II.5. Referuar materialeve të fashikullit të shqyrtimit administrativ rezulton, se në datën 23.03.2023 operatori ekonomik “Power Industries” SHPK ka paraqitur pranë Komisionit të Prokurimit Publik ankesën me nr. 619 prot., me objekt kundërshtimin e vendimit të autoritetit kontraktor lidhur me kualifikimin e operatorit ekonomik “Zeqiri” SHPK në procedurën e prokurimit objekt-ankimi.

II.6. Në përputhje me nenin 112 “Veprimet paraprake” të Ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Komisioni i Prokurimit Publik me marrjen e ankesës, e publikoi atë në bazën e të dhënave të tij, e cila përmban të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe publikoi formularin e publikimit nr. 619/2 prot datë 24.03.2023 referuar kritereve të cilat operatori ekonomik ankimues “Power Industries” SHPK pretendon, se nuk përmbushen nga operatori ekonomik pjesëmarrës në procedurë “Zeqiri” SHPK. Nga informacioni i autoritetit kontraktor rezulton, se ankesa është dorëzuar në autoritet kontraktor me datë 24.03.2023.

II.7. Me datë 27.03.2023 me nr. 619/3 prot., dhe me datë 28.03.2023 me nr. 619/4 prot., operatori ekonomik “Zeqiri” SHPK në cilësinë e operatorit ekonomik te interesuar ka depozituar në KPP formularin e paraqitjes së argumenteve në përputhje me nenin 113 të LPP-së.

II.8. Me shkresën nr. 28/8 prot., datë 03.04.2023 protokolluar me tonën me nr. 619/5 prot., datë 05.04.2023 është dërguar pranë Komisionit të Prokurimit Publik, vendimi i autoritetit kontraktor lidhur me trajtimin e ankesës së paraqitur nga operatori ekonomik “Power Industries” SHPK, për procedurën e mësipërme të prokurimit, në të cilën është vendosur pranimi pjesërisht i ankesës. Konkretisht, autoriteti kontraktor në vendimin e sipërcituar ka arsyetuar si më poshtë:

Pas vlerësimit të dokumentacionit, KSHA konstatohen se: 1. Për pikën 1 të ankesës, ku citohet: “..Operatori ekonomik “Zeqiri” nuk ka shlyer detyrimet e energjisë elektrike, për muajin janar 2023, kur data e zhvillimit të kësaj procedure prokurimi është 01.03.2023...u shqyrtua

dokumentacioni i dorëzuar nga Operatori ekonomik “Zeqiri”, i cili e plotëson këtë kriter me anë të vertetimit me Nr. 117 prot., datë 03.02.2023 lëshuar nga Furnizuesi i Shërbimit universal FSHU. 2. Për pikën 2 të ankesës, ku citohet: “..Operatori ekonomik “Zeqiri” nuk plotëson kriterin Çertifikate standarti EN 840-2-5-6 (standart nderkombetar) ose SSH/EN 840- 4 52 SSH/EN 840-5: SSH/EN 840-6 të mallit objekt prokurimi për kontenierin plastik 1100L...” nga shqyrtimi i dokumentacionit të Operatorit ekonomik “Zeqiri”, u konstatua se Çertifikata standarti EN 840-2-5-6 (standart nderkombetar) nuk përmban objektin e prokurimit i cili është kriteri i kërkuar në pikën 2.3d të kapacitetit teknik. Ky kriter nuk plotësohet nga operatori ekonomik “Zeqiri”. 3. Për pikë 3 të ankesës, ku citohet: “..Operatori ekonomik “Zeqiri” nuk plotëson Specifikimet teknike: Kazane plastik per mbetje urbane me kapacitet 1100 Litra. • Përmasat e kontenierit: Lartesia: 1340-136 0 mm, Trashesia Thellesia: 1050- 1080 mm: Gjeresia: 1350-1380 mm. • Trupi i kontenierit të ndërtohet nga material plastik (HDPE), jo i demshem nga rrezet UV, dhe rezistent ndaj temperaturave te ulta (deri ne -30“C) dhe te larta (deri ne +80°C). • Kontenieri te jete ne gjendje te duroje kushtet klimaterike te ndryshme, per te gjithë perberesit, dhe temperatura nga -20°C deri +50° C • Kontenieri te jete ne perputhje me standartin RAL GZ 951/1 dhe AfPS GS2019...” u konstatua se katalogu i paraqitur, me të dhënat e mallit të ofruar nuk janë konform specifikimeve teknike të mallit të kërkuar nga AK. Ky kriter nuk plotësohet nga operatori ekonomik “Zeqiri”. Gjithashtu operatori ekonomik “Zeqiri” nuk plotëson kriterin për pikat: 2.3 b. Operatori ekonoinmik ofertues duhet të jetë i pajisur me Çertifikatën ISO 9001:2015 ose ekuivalente, lidhur me sistemin 2 menaxhimit të cilësisë, e cila të përfshijë objektin e prokurimit si dhe të Jetë e vlefshme. 2.3.c. Operatori ekonomik ofertues duhet të jetë i pajisur me Çertifikatën ISO 14001:2015 ose ekuivalente, lidhur me sistemin e menaxhimit të mjedisit, e cila të përfshijë objektin e Prokurimit si dhe të jetë e vlefshme. ”, pasi të dyja ISO-t e kërkuara nuk përmbajë objektin e prokurimit. Komisioni i Shqyrtimit të Ankesës, gjithashtu konstatoi se edhe operatori ankimues “Power Industries” Shpk, nuk plotëson kriteret për kualifikim, përkatësisht pikat si më poshtë vijon: 1. Pikën 2.3 të kapacitetit teknik b dhe c: “ 2.3 b. Operatori ekonomik ofertues duhet të jetë i pajisur me Çertifikatën ISO 9001:2015 ose ekuivalente, lidhur me sistemin e menaxhimit të cilësisë, e cila të përfshijë objektin e prokurimit si dhe të jetë e vlefshme. 1.3.c. Operatori ekonomik ofertues duhet të jetë i pajisur me Çertifikatën ISO 14001:2015 ose ekuivalente, lidhur me sistemin e menaxhimit të mjedisit, e cila të përfshijë objektin e prokurimit si dhe të jetë e vlefshme. ”, pasi të dyja ISO-t e kërkuara nuk përmbajë objektin e prokurimit. Pikën 2.3 gj ku citohet: “..Ne menyre qe te krahasohet pajtueshmeria me specifikimet teknike, operatori ekonomik ofertues duhet te paraqese katalogun/et ose fragmente të katalogut/eve prodhuesit/ve te mallrave objekt prokurimi, per te gjitha zerat objekt prokurimi ne te cilet te tregohen dhe te specifikohen qarte mallrat qe do te ofrohen. ” u konstatua se katalogu i paraqitur, me të dhënat e mallit të ofruar nuk janë konform specifikimeve teknike të mallit të kërkuar nga AK. Ky kriter nuk plotësohet nga operatorit ekonomik “POWER INDUSTRIES” Shpk.

Për sa trajtuam më lart, Komisioni i Shqyrtimit të Ankesës, VENDOSI: 1. Pranimin e pjesshëm të ankesës të operatorit ekonomik “POWER INDUSTRIES” Shpk për kontratën me numër të

referencës: REF-5808 1-02-06-2023, me objekt: “Blerje kazane për mbetjet urbane”. 2. Për zbatimin e këtij vendimi dhe vijimin e procedurave të mëtejshme në zbatim të Ligjit Nr. 16212020, “Për Prokurimin Publik” dhe Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” ngarkohet Njësia e Prokurimit Publik dhe KVO-në.”

II.9. Me shkresën me nr. 619/6 prot., datë 07.04.2023 me lëndë “Kërkesë për informacion” KPP ju drejtua autoritetit kontraktor dhe për dijeni operatorit ekonomik “Zeqiri” SHPK duke kërkuar sa më poshtë vijon:

“[...] Bazuar në nenin 113 dhe 114 pika 4 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” kërkojmë të na informoni për sa më poshtë: 1. A ka paraqitur argumente pranë autoritetit tuaj kontraktor në cilësinë e operatorit ekonomik të interesuar, operatori ekonomik “Zeqiri” SHPK ? 2. A e kenë njoftuar operatorin ekonomik “Zeqiri” SHPK lidhur me vendimmarrjen e autoritetit tuaj kontraktor për ankesën e operatorit ekonomik “Power Industries” SHPK? [...]”

II.10. Me shkresën e datës 13.04.2023 me nr. 28/10 prot., me lëndë “Dërgim informacioni për shkresën nr. 619/6 dt. 07.04.2023” protokolluar me tonën me nr. 619/7 prot., datë 18.04.2023 autoriteti kontraktor ka njoftuar KPP-në si më poshtë;

Lidhur me informacionin që ju kërkonte: 1. Operatori “Zeqiri” SHPK me NIPT: J67902827A ka paraqitur pranë autoritetit tone argumentime protokolluar me nr. 28/5 prot date 28/03/2023. 2. Operatori ekonomik “Zeqiri” shpk është njoftuar nëpërmjet email-t zyrtar të përsoneit përgjegjës për këtë procedurë. Bashkëngjitur materiali fotokopje nga dosja të argumentimeve si dhe kopje të emaili-t. 1. Formulari i paraqitjes së argumentimeve nga operatori ekonomik i interesuar. 9 (nëntë) fletë 2. Kopje e emaili-t mbi vendimi e KSHA për operatorët “Zeqiri” SHPK dhe “Power Industries” ShPK. 2 (fletë)”

II.13. Në datën 25.04.2023 me vendimin nr. 294/2021 Komisioni i Prokurimit Publik ka vendosur:

1. Të mbyllë çështjen mbi ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “Power Industries” SHPK, për procedurën e prokurimit “Procedurë e hapur”, me Nr. REF58081-02-06-2023 me objekt “Blerje Kazane per mbetje urbane” me fond limit: 29.869.700 (Njëzetë e nëntë milion e tetëqind e gjashtëdhjetë e nëntë mijë e shtatëqind) lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 01.03.2023 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Durrës.
2. Autoriteti kontraktor lejohet të vijojë me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit.

3. *Ngarkohet zyra e financës që të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “Power Industries” SHPK.*
4. *Kopje e këtij vendimi t’i dërgohet Agjencisë së Prokurimit Publik. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.*

II.16. Në datën 11.05.2023, është publikuar njoftimi i fituesit në Sistemin e Prokurimit Elektronik prej të cilës rezulton fitues operatori ekonomik “ZEQIRI” SHPK.

II.17. Në datën 16.05.2023 autoriteti kontraktor ka kryer në sistemin e prokurimeve elektronike procesin e rivlerësimit (si rezultat i ankesës së paraqitur nga operatori ekonomik Power Industries” SHPK ku kërkonte skualifikimin e operatorit ekonomik “Zeqiri”SHPK), të procedurës si më poshtë:

1. “Leon Konstruksion” SHPK 22 750 000 lekë skualifikuar
2. “Zeqiri” SHPK 26 397 000 lekë skualifikuar
3. “Power Industries”SHPK 28 980 000 lekë Skualifikuar
4. “Vibtis” 29 620 500 lekë skualifikuar

II.18. Më datë 16.05.2023 autoriteti kontraktor, nëpërmjet sistemit të prokurimeve elektronike, ka njoftuar operatorin ekonomik Power Industries” SHPK për rivlerësimin e procedurës së prokurimit nga ku rezulton, se ky operator ekonomik është skualifikuar me arsyet si më poshtë vijojnë:

operatori ekonomik “Power Industries” SHPK nuk plotëson kriteret për kualifikim përkatësisht pikat si më poshtë vijon: 1. Pikën 2.3. të kapacitetit teknik b dhe c : 2.3. b. operatori ekonomik ofertues duhet të jetë I pajisur me certifikatën iso 9001:2015 ose ekuivalente , lidhur me sistemin e menaxhimit të cilësisë e cila të përfshijë objektin e prokurimit si dhe të jetë e vlefshme . 1.3.c. operatori ekonomik ofertues duhet të jetë i pajisur me certifikatën iso 14001:2015 ose ekuivalente lidhur me sistemin e menaxhimit të mjedisit e cila të përfshijë objektin e prokurimit si dhe të jetë e vlefshme pasi të dyja isot-ot e kërkuara nuk përmbajnë objektin e prokurimit . Pikën 2.3.gj ku citohet: Ne menyre qe te krahasohet pajtueshmeria me specifikimet teknike, operatori ekonomik ofertues duhet te paraqese katalogun/et ose fragmente të katalogut/eve prodhuesit/ve te mallrave objekt prokurimi, per te gjitha zerat objekt prokurimi ne te cilet te tregohen dhe te specifikohen qarte mallrat qe do te ofrohen. U konstatua se katalogu I paraqitur me të dhënat e mallit të ofruar nuk janë conform specifikimeve teknike të mallit të kërkuar nga AK. Ky kriter nuk plotësohet nga operatori ekonomik “Power Industries” SHPK

II.19. Nga verifikimet në sistemin e prokurimeve elektronike rezulton, se në datën 15.05.2023 autoriteti kontraktor ka vendosur anulimin e procedurës së prokurimit objekt-ankimi.

II.20. Në datën 19.05.2023, pranë Komisionit të Prokurimit Publik, është administruar ankesa me nr. 1119 protokoli e operatorit ekonomik “Power Industries” SHPK për procedurën e prokurimit “Procedurë e hapur”, me Nr. REF-58081-02-06-2023, me objekt: “Blerje Kazane për mbetje urbane” me fond limit 29.869.700 (Njëzetë e nëntë milion e tetëqind e gjashtëdhjetë e nëntë mijë e shtatëqind) lekë pa TVSH, zhvilluar me datë 01.03.2023 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Durrës.

Nga shqyrtimi paraprak i ankesës të sipërcituar, u konstatua se objekti i ankesës lidhet me vendimmarrjen e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi skualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik ankimues “Power Industries” SHPK .

II.21. Në përputhje me nenin 112 “Veprimet paraprake” të Ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Komisioni i Prokurimit Publik me marrjen e ankesës, e publikoi atë në bazën e të dhënave të tij, e cila përmban të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe është publikuar formulari i publikimit nr. 1119/2 Prot., date 22.05.2023, duke referuar arsyet mbi skualifikimin e ofertës së operatorit ekonomik ankimues “Power Industries” SHPK, nga procedura e prokurimit të sipërcituar.

II.22. Nëpërmjet shkresës nr. 28/17 prot., datë 02.06.2023 protokolluar me tonën me nr. 1119/3 prot., datë 07.06.2023 është depozituar pranë Komisionin e Prokurimit Publik informacioni, dokumentacioni, si dhe vendimi mbi trajtimin e ankesës së operatorit ekonomik ankimues, ku rezulton se është vendosur refuzimi i ankesës lidhur me arsyet e skualifikimit.

III

Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesës, dhe dokumentacionit bashkëngjitur saj,

Arsyeton

III.1. Para shqyrtimit në themel të pretendimeve të operatorit ekonomik “Power Industries” SHPK, në zbatim të nenit 29, pika 2 të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, në të cilin parashikohet se “1. Komisioni shqyrton ankesën brenda objektit dhe shkaqeve të parashtruara në ankesë. 2. Përgjashtimisht, kur ka lidhje midis objektit të ankesës dhe vendimeve apo veprimeve të tjera të autoritetit kontraktor gjatë procedurës së prokurimit,

Komisioni vendos edhe për ligjshmërinë e tyre”, nisur nga arsyeja e skualifikimit të operatorit ekonomik ankimues, Komisioni i Prokurimit Publik, gjykon të ndalet fillimisht në ligjshmërinë e veprimeve të autoritetit kontraktor, për sa kohë që objekti i ankesës ka lidhje me vendimet dhe veprimet e ndërmarra kryesisht nga autoritetit kontraktor gjatë zbatimit të hapave të mëtejshëm të procedurës së prokurimit objekt-ankimi.

III.1.1. Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankimues Power Industries” SHPK, për skualifikimin e ofertës së tij me arsyet:

operatori ekonomik “Power Industries” SHPK nuk plotëson kriteret për kualifikim përkatësisht pikat si më poshtë vijon: 1. Pikën 2.3. të kapacitetit teknik b dhe c : 2.3. b. operatori ekonomik ofertues duhet të jetë I pajisur me certifikatën iso 9001:2015 ose ekuivalente , lidhur me sistemin e menaxhimit të cilësisë e cila të përfshijë objektin e prokurimit si dhe të jetë e vlefshme . 1.3.c. operatori ekonomik ofertues duhet të jetë i pajisur me certifikatën iso 14001:2015 ose ekuivalente lidhur me sistemin e menaxhimit të mjedisit e cila të përfshijë objektin e prokurimit si dhe të jetë e vlefshme pasi të dyja isot-ot e kërkuara nuk përmbajnë objektin e prokurimit . Pikën 2.3.gj ku citohet: Ne menyre qe te krahasohet pajtueshmeria me specifikimet teknike, operatori ekonomik ofertues duhet te paraqese katalogun/et ose fragmente të katalogut/eve prodhuesit/ve te mallrave objekt prokurimi, per te gjitha zerat objekt prokurimi ne te cilet te tregohen dhe te specifikohen qarte mallrat qe do te ofrohen. U konstatua se katalogu I paraqitur me të dhënat e mallit të ofruar nuk janë conform specifikimeve teknike të mallit të kërkuar nga AK. Ky kriter nuk plotësohet nga operatori ekonomik “Power Industries” SHPK.

III.1.2. Në datën 01.03.2023, autoriteti kontraktor ka zhvilluar procedurën e prokurimit.

III.1.3. Në datën 13.03.2023 operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurën e prokurimit janë njoftuar elektronikisht mbi klasifikimin përfundimtar të ofertave për vlerat pa TVSH si më poshtë:

1. “Leon Konstruksion” SHPK 22 750 000 lekë skualifikuar
2. “Zeqiri” SHPK 26 397 000 lekë **kualifikuar**
3. “Power Industries” SHPK 28 980 000 lekë **kualifikuar**
4. “Vibtis” 29 620 500 lekë skualifikuar

III.1.4. Nga verifikimet në Sistemin e Prokurimeve Elektronike rezulton, se më datë 20.03.2023 është publikuar Njoftimi i Fituesit paraprak për procedurën e prokurimit objekt-ankimi.

III.1.5. Referuar materialeve të fashikullit të shqyrtimit administrativ rezulton, se në datën 23.03.2023 operatori ekonomik “Power Industries” SHPK ka paraqitur pranë Komisionit të Prokurimit Publik ankesën me nr. 619 prot., me objekt kundërshtimin e vendimit të autoritetit

kontraktor lidhur me kualifikimin e operatorit ekonomik “Zeqiri” SHPK në procedurën e prokurimit objekt-ankimi.

III.1.6. Në përputhje me nenin 112 “Veprimet paraprake” të Ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Komisioni i Prokurimit Publik me marrjen e ankesës, e publikoi atë në bazën e të dhënave të tij, e cila përmban të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe publikoi formularin e publikimit nr. 619/2 prot datë 24.03.2023 referuar kritereve të cilat operatori ekonomik ankimues “Power Industries” SHPK pretendon, se nuk përmbushen nga operatori ekonomik pjesëmarrës në procedurë “Zeqiri” SHPK. Nga informacioni i autoritetit kontraktor rezulton se ankesa është dorëzuar në autoritet kontraktor me datë 24.03.2023.

III.1.7. Me datë 27.03.2023 me nr. 619/3 prot., dhe me datë 28.03.2023 me nr. 619/4 prot., operatori ekonomik “Zeqiri” SHPK në cilësinë e operatorit ekonomik te interesuar ka depozituar në KPP formularin e paraqitjes së argumenteve në përputhje me nenin 113 të LPP-së.

III.1.8. Me shkresën nr. 28/8 prot., datë 03.04.2023 protokolluar me tonën me nr. 619/5 prot., datë 05.04.2023 është dërguar pranë Komisionit të Prokurimit Publik, vendimi i autoritetit kontraktor lidhur me trajtimin e ankesës së paraqitur nga operatori ekonomik “Power Industries” SHPK, për procedurën e mësipërme të prokurimit, në të cilën është vendosur pranimi pjesërisht i ankesës. Konkretisht, autoriteti kontraktor në vendimin e sipërcituar ka arsyetuar si më poshtë:

Pas vlerësimit të dokumentacionit, KSHA konstatohen se: 1. Për pikën 1 të ankesës, ku citohet: “..Operatori ekonomik “Zeqiri” nuk ka shlyer detyrimet e energjisë elektrike, për muajin janar 2023, kur data e zhvillimit të kësaj procedure prokurimi është 01.03.2023...u shqyrtua dokumentacioni i dorëzuar nga Operatori ekonomik “Zeqiri”, i cili e plotëson këtë kriter me anë të vertetimit me Nr. 117 prot., datë 03.02.2023 lëshuar nga Furnizuesi i Shërbimit universal FSHU. 2. Për pikën 2 të ankesës, ku citohet: “..Operatori ekonomik “Zeqiri” nuk plotëson kriterin Çertifikate standarti EN 840-2-5-6 (standart nderkombetar) ose SSH/EN 840- 4 52 SSH/EN 840-5: SSH/EN 840-6 të mallit objekt prokurimi për kontenierin plastik 1100L...” nga shqyrtimi i dokumentacionit të Operatorit ekonomik “Zeqiri”, u konstatua se Çertifikata standarti EN 840-2-5-6 (standart nderkombetar) nuk përmban objektin e prokurimit i cili është kriteri i kërkuar në pikën 2.3d të kapacitetit teknik. Ky kriter nuk plotësohet nga operatori ekonomik “Zeqiri”. 3. Për pikë 3 të ankesës, ku citohet: “..Operatori ekonomik “Zeqiri” nuk plotëson Specifikimet teknike: Kazane plastik per mbetje urbane me kapacitet 1100 Litra. • Përmasat e kontenierit: Lartesia: 1340-136 0 mm, Trashesia/Thellesia: 1050- 1080 mm: Gjerësia: 1350-1380 mm. • Trupi i kontenierit të ndërtohet nga material plastik (HDPE), jo i demshem nga rrezet UV, dhe rezistent ndaj temperaturave te ulta (deri ne -30“C) dhe te larta (deri ne +80°C). • Kontenieri te jete ne gjendje te duroje kushtet klimaterike te ndryshme, per te gjithe perberesit, dhe temperatura nga -20°C deri +50° C • Kontenieri te jete ne perputhje me

standartin RAL GZ 951/1 dhe AfPS GS2019...” u konstatua se katalogu i paraqitur, me të dhënat e mallit të ofruar nuk janë konform specifikimeve teknike të mallit të kërkuar nga AK. Ky kriter nuk plotësohet nga operatori ekonomik “Zeqiri”. Gjithashtu operatori ekonomik “Zeqiri” nuk plotëson kriterin për pikat: 2.3 b. Operatori ekonomik ofertues duhet të jetë i pajisur me Çertifikatën ISO 9001:2015 ose ekuivalente, lidhur me sistemin 2 menaxhimit të cilësisë, e cila të përfshijë objektin e prokurimit si dhe të jetë e vlefshme. 2.3.c. Operatori ekonomik ofertues duhet të jetë i pajisur me Çertifikatën ISO 14001:2015 ose ekuivalente, lidhur me sistemin e menaxhimit të mjedisit, e cila të përfshijë objektin e Prokurimit si dhe të jetë e vlefshme. ”, pasi të dyja ISO-t e kërkuara nuk përmbajë objektin e prokurimit. Komisioni i Shqyrtimit të Ankesës, gjithashtu konstatoi se edhe operatori ankimes “Power Industries” ShPK, nuk plotëson kriteret për kualifikim, përkatësisht pikat si më poshtë vijon: 1. Pikën 2.3 të kapacitetit teknik b dhe c: “ 2.3 b. Operatori ekonomik ofertues duhet të jetë i pajisur me Çertifikatën ISO 9001:2015 ose ekuivalente, lidhur me sistemin e menaxhimit të cilësisë, e cila të përfshijë objektin e prokurimit si dhe të jetë e vlefshme. 1.3.c. Operatori ekonomik ofertues duhet të jetë i pajisur me Çertifikatën ISO 14001:2015 ose ekuivalente, lidhur me sistemin e menaxhimit të mjedisit, e cila të përfshijë objektin e prokurimit si dhe të jetë e vlefshme. ”, pasi të dyja ISO-t e kërkuara nuk përmbajë objektin e prokurimit. Pikën 2.3 gj ku citohet: “..Ne menyre qe te krahasohet pajtueshmeria me specifikimet teknike, operatori ekonomik ofertues duhet te paraqese katalogun/et ose fragmente të katalogut/eve prodhuesit/ve te mallrave objekt prokurimi, per te gjitha zerat objekt prokurimi ne te cilet te tregohen dhe te specifikohen qarte mallrat qe do te ofrohen. ” u konstatua se katalogu i paraqitur, me të dhënat e mallit të ofruar nuk janë konform specifikimeve teknike të mallit të kërkuar nga AK. Ky kriter nuk plotësohet nga operatorit ekonomik “POWER INDUSTRIES” Shpk.

Për sa trajtuam më lart, Komisioni i Shqyrtimit të Ankesës, VENDOSI: 1. Pranimin e pjesshëm të ankesës të operatorit ekonomik “POWER INDUSTRIES” Shpk për kontratën me numër të referencës: REF-5808 1-02-06-2023, me objekt: “Blerje kazane për mbetjet urbane”. 2. Për zbatimin e këtij vendimi dhe vijimin e procedurave të mëtejshme në zbatim të Ligjit Nr. 1621/2020, “Për Prokurimin Publik” dhe Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” ngarkohet Njësia e Prokurimit Publik dhe KVO-në.”

III.1.9. Në datën 25.04.2023 me vendimin nr. 294/2021 Komisioni i Prokurimit Publik ka vendosur:

1. Të mbyllë çështjen mbi ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “Power Industries” SHPK, për procedurën e prokurimit “Procedurë e hapur”, me Nr. REF58081-02-06-2023 me objekt “Blerje Kazane per mbetje urbane” me fond limit: 29.869.700 (Njëzet e nëntë milion e tetëqind e gjashtëdhjetë e nëntë mijë e shtatëqind) lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 01.03.2023 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Durrës.

2. . Autoriteti kontraktor lejohet të vijojë me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit.
3. Ngarkohet zyra e financës që të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “Power Industries” SHPK.
4. Kopje e këtij vendimi ti dërgohet Agjencisë së Prokurimit Publik. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

III.1.10. Në datën 16.05.2023 autoriteti kontraktor ka kryer në sistemin e prokurimeve elektronike procesin e rivlerësimit (si rezultat i ankesës së paraqitur nga operatori ekonomik Power Industries” SHPK ku kërkonte skualifikimin e operatorit ekonomik “Zeqiri” SHPK), të procedurës si më poshtë:

1. “Leon Konstruksion” SHPK 22 750 000 lekë skualifikuar
2. “Zeqiri” SHPK 26 397 000 **lekë skualifikuar**
3. “Power Industries” SHPK 28 980 000 **lekë Skualifikuar**
4. “Vibtis” 29 620 500 lekë skualifikuar

III.1.11. Më datë 16.05.2023 autoriteti kontraktor, nëpërmjet sistemit të prokurimeve elektronike, ka njoftuar operatorin ekonomik Power Industries” SHPK për rivlerësimin e procedurës së prokurimit nga ku rezulton, se ky operator ekonomik është skualifikuar me arsyet si më poshtë vijojnë:

operatori ekonomik “Power Industries” SHPK nuk plotëson kriteret për kualifikim përkatësisht pikat si më poshtë vijon: 1. Pikën 2.3. të kapacitetit teknik b dhe c : 2.3. b. operatori ekonomik ofertues duhet të jetë I pajisur me certifikatën iso 9001:2015 ose ekuivalente , lidhur me sistemin e menaxhimit të cilësisë e cila të përfshijë objektin e prokurimit si dhe të jetë e vlefshme . 1.3.c. operatori ekonomik ofertues duhet të jetë i pajisur me certifikatën iso 14001:2015 ose ekuivalente lidhur me sistemin e menaxhimit të mjedisit e cila të përfshijë objektin e prokurimit si dhetë jetë e vlefshme pasi të dyja isot-ot e kërkuara nuk përmbajnë objektin e prokurimit . Pikën 2.3.gj ku citohet: Ne menyre qe te krahasohet pajtueshmeria me specifikimet teknike, operatori ekonomik ofertues duhet te paraqese katalogun/et ose fragmente të katalogut/eve prodhuesit/ve te mallrave objekt prokurimi, per te gjitha zerat objekt prokurimi ne te cilet te tregohen dhe te specifikohen qarte mallrat qe do te ofrohen. U konstatua se katalogu I paraqitur me të dhënat e mallit të ofruar nuk janë conform specifikimeve teknike të mallit të kërkuar nga AK. Ky kriter nuk plotësohet nga operatori ekonomik “Power Industries” SHPK.

III.1.12. Nga verifikimet në sistemin e prokurimeve elektronike rezulton, se në datën **15.05.2023** autoriteti kontraktor ka vendosur anulimin e procedurës së prokurimit objekt-ankimi.

III.1.13. Në datën 19.05.2023, pranë Komisionit të Prokurimit Publik, është administruar ankesa me nr. 1119 protokolli e operatorit ekonomik “Power Industries” SHPK për procedurën e

prokurimit “Procedurë e hapur”, me Nr. REF-58081-02-06-2023, me objekt: “Blerje Kazane për mbetje urbane” me fond limit 29.869.700 (Njëzet e nëntë milion e tetëqind e gjashtëdhjetë e nëntë mijë e shtatëqind) lekë pa TVSH, zhvilluar me datë 01.03.2023 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Durrës.

Nga shqyrtimi paraprak i ankesës të sipërcituar, u konstatua se objekti i ankesës lidhet me vendimmarrjen e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi skualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik ankimues “Power Industries” SHPK .

III.1.14. Në përputhje me nenin 112 “Veprimet paraprake” të Ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Komisioni i Prokurimit Publik me marrjen e ankesës, e publikoi atë në bazën e të dhënave të tij, e cila përmban të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe është publikuar formulari i publikimit nr. 1119/2 Prot., date 22.05.2023, duke referuar arsyet mbi skualifikimin e ofertës së operatorit ekonomik ankimues “Power Industries” SHPK, nga procedura e prokurimit të sipërcituar.

III.1.15. Nëpërmjet shkresës nr. 28/17 prot., datë 02.06.2023 protokolluar me tonën me nr. 1119/3 prot., datë 07.06.2023 është depozituar pranë Komisionin e Prokurimit Publik informacioni, dokumentacioni, si dhe vendimi mbi trajtimin e ankesës së operatorit ekonomik ankimues, ku rezulton se është vendosur refuzimi i ankesës lidhur me arsyet e skualifikimit.

III.1.16. Në nenin 2 “Qëllimi” të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, parashikohet shprehimisht se: *“Qëllim i këtij ligji është:*

- a) të rrisë efikasitetin dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik;*
- b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale;*
- c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik;*
- ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë;*
- d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik*
- dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik.”*

Ndërkohe në nenin 3 “Parime të përgjithshme” të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, parashikohet shprehimisht se:

- “1. Autoritetet dhe entet kontraktore garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe veprojnë me transparencë e në mënyrë proporcionale.*
- 2. Autoritetet dhe entet kontraktore nuk duhet të shmangin fushën e zbatimit të këtij ligji ose të ngushtojnë në mënyrë artificiale konkurrencën. Konkurrenca konsiderohet se është ngushtuar artificialisht kur prokurimi përgatitet me qëllimin për të favorizuar ose dëmtuar në mënyrë të padrejtë operatorë ekonomikë të caktuar.*

3. Autoritetet dhe entet kontraktore janë të detyruara të zbatojnë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin mjedisor, social e të punës dhe në dispozitat e marrëveshjeve dhe konventat ndërkombëtare, të ratifikuara në përputhje me Kushtetutën.”

III.1.17. Në udhëzimin nr. 07, datë 30.07.2021 “Për mënyrën e zhvillimit të procedurave të prokurimit me mjete elektronike”, parashikohet shprehimisht se:

Pas përfundimit të procesit të vlerësimit nga të gjithë anëtarët e KVO për të gjitha ofertat e dorëzuara nga operatorët ekonomikë, anëtari i autorizuar i njësisë së prokurimit duhet të bëjë në sistem mbylljen e fazës së vlerësimit të ofertave në sistem. Në këtë moment sistemi iu dërgon në mënyrë elektronike automatikisht njoftimin mbi klasifikimin e gjithë operatorëve ekonomikë pjesëmarrës.

III.1.18. Në pikat 1 dhe 2 të nenit 82 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit”, të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” përcaktohet se: “1. Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoritetet ose entet kontraktore pranojnë si provë paraprake në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas parashikimeve të këtij ligji. Përmbajtja e këtij formulari përcaktohet në rregullat e prokurimit publik. Kur autoriteti ose enti kontraktor mund t'i marrë dokumentet mbështetëse duke u futur direkt në një bazë të aksesueshme të dhënash shtetërore, në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit përcaktohet edhe informacioni që kërkohet për këtë qëllim, siç është adresa në internet e bazës të të dhënave, çdo e dhënë identifikimi dhe, sipas rastit, në deklaratën e nevojshme për dhënien e pëlqimit. Operatorët ekonomikë mund të përdorin një formular vetëdeklarimi që është përdorur gjatë një procedure prokurimi të mëparshme, nëse informacioni që ajo përmban vazhdon të jetë i saktë dhe i vlefshëm.

2. Në çdo kohë gjatë procedurës, autoriteti ose enti kontraktor mund t'u kërkojë ofertuesve dhe kandidatëve sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime, kur kjo është e nevojshme për të garantuar zbatimin korrekt të procedurës.

III.1.19. Në nenin 26 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit”, pikat 1, 2, 3, 6 dhe 7 të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: “Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, **autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla.**

2. Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit përmban informacion dhe deklarin, si më poshtë vijon:

- a) operatori ekonomik është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin ose sipas legjislacionit të posaçëm, në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv;
- b) operatori ekonomik nuk është dënuar për asnjë nga veprat penale, të parashikuara në pikën 1, të nenit 76, të LPP-së;
- c) personi/at në cilësinë e anëtarit të organit administrativ, drejtuesit ose mbikëqyrësit, aksionerit ose ortakut, ose që ka kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda operatorit ekonomik, nuk është ose ka qenë i dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për asnjë nga veprat penale, të përcaktuara në pikën 1, të nenit 76, të LPP-së;
- ç) operatori ekonomik nuk është dënuar me vendim të gjykatës së formës së prerë, për vepra që lidhen me veprimtarinë profesionale;
- d) operatori ekonomik nuk është në proces falimentimi;
- dh) operatori ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet për pagimin e taksave dhe tatimeve 1 të kontributeve të sigurimeve shoqërore, sipas parashikimeve të pikës 2, të nenit 76, të LPP-së;
- e) operatori ekonomik ka shlyer të gjitha detyrimet e maturuara të energjisë elektrike, dhe përmbush kërkesat që rrjedhin nga legjislacioni i fushës në fuqi. Ky informacion kërkohet për operatorët ekonomikë, të cilët ushtrojnë veprimtarinë në territorin e Republikës së Shqipërisë;
- ë) operatori ekonomik nuk ndodhet në kushtet e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi;
- f) operatori ekonomik ushtron aktivitetin në zbatim të kërkesave ligjore të legjislacionit mjedisor, social dhe të punës;
- g) operatori ekonomik ka paraqitur ofertë të pavarur, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi;
- gj) operatori ekonomik përmbush specifikimet teknike, sipas kërkesave të përcaktuara nga autoriteti/enti kontraktor;
- h) operatori ekonomik disponon fuqinë punëtore, të nevojshme për ekzekutimin e kontratës, sipas kërkesave të autoritetit/entit kontraktor (kur është rasti);
- i) operatori ekonomik disponon mjetet dhe makineritë e nevojshme për ekzekutimin e kontratës, sipas kërkesave të autoritetit/entit kontraktor, kur është rasti;
- j) informacion mbi subjektet, mbi kapacitetet e të cilave, operatori ekonomik do të mbështetet, nëse është rasti dhe nënkontraktorët e mundshëm, nëse është rasti;
- k) operatori ekonomik ushtron aktivitetin konform kërkesave të legjislacionit në fuqi.

3. Informacioni i pasqyruar në formularin e vetëdeklarimit, i cili gjendet në një bazë të dhënash, ku autoriteti/enti kontraktor mund të aksesojë direkt këtë informacion dhe /ose dokumentin, duhet të shoqërohet me adresën përkatëse për këtë bazë të dhënash.

4. Për përmbushjen e detyrimit sipas këtij neni, operatorët ekonomikë mund të përdorin një formular vetëdeklarimi që është përdorur gjatë një procedure prokurimi të mëparshme, nëse informacioni që ajo përmban vazhdon të jetë i saktë dhe i vlefshëm.

5. Operatorëve ekonomikë nuk u kërkohet të dorëzojnë dokumente mbështetëse, kur autoriteti ose enti kontraktor që ka dhënë kontratën ose ka lidhur marrëveshjen kuadër, i ka këto dokumente.

6. Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin.

III.1.20. Në nenin 82 pika 1 dhe 2 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar përcaktohet se: “

1. Kohëzgjatja e procedurës së vlerësimit nuk duhet të kalojë 20 (njëzet) ditë për procedurat mbi kufirin e lartë monetar dhe 15 (pesëmbëdhjetë) ditë për procedurat nën kufirin e lartë monetar, përveç rasteve të tjera të cilësuara ndryshe në këto rregulla.

Në rast se komisionit të vlerësimit të ofertave i lind nevoja për verifikime ose ndryshime të një apo më shumë anëtarëve, afati i vlerësimit pezullohet në momentin e paraqitjes së kërkesës për verifikim apo ndryshim dhe rifillon aty ku është pezulluar, me marrjen e përgjigjes apo zyrtarizimit të anëtarit/anëtarëve.

2. Komisioni i vlerësimit të ofertave verifikon dhe vlerëson ofertat e dorëzuara, duke kualifikuar vetëm ato oferta, që përmbushin kërkesat për kualifikim, të përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe janë të përgjegjshme/vlefshme.

Një ofertë e përgjegjshme/vlefshme është ajo që plotëson kërkesat e dokumenteve të tenderit pa devijim material, rezervë ose mospranim, siç përcaktohet më poshtë:

- i. “Devijimi” është shmangia e ofertuesit nga kërkesat e specifikuara në dokumentet e tenderit;
- ii. “Rezervimi” është përcaktimi, nga ana e ofertuesit, i kushteve kufizuese ose ndalimi nga pranimi i plotë i kërkesave të specifikuara në dokumentet e tenderit; dhe
- iii. “Mospranimi” është mosparaqitja e një pjese ose e të gjithë informacionit ose dokumenteve të kërkuara në dokumentet e tenderit.

Nëse është e nevojshme, komisioni i vlerësimit të ofertave kërkon sqarime nga ofertuesit, të cilat duhet të jenë me shkrim ose të reflektuara në procesverbal. Në çdo rast, kur autoriteti/enti kontraktor vendos të marrë në konsideratë sqarimet e operatorit ekonomik, nuk duhet të bjerë në kundërshtim me përcaktimet në këtë pikë.”

III.1.21. Në rastin konkret, nisur nga arsyeja e skualifikimit, si dhe pretendimet e operatorit ekonomik ankimues, KPP vëren, se momenti procedural i verifikimit të dokumentave nga ana e autoritetit kontraktor për përmbushjen e kriterëve të përgjithshme dhe të veçanta të kualifikimit “(jo dokumentacioni i deklaruar në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit) për operatorin ekonomik “Power Industries” SHPK, duhet të ishte data 13.03.2023, datë në të cilën referuar dhe sistemit prokurimeve elektronike rezultoi të jetë përmbyllur dhe procesi i vlerësimit të ofertave nga ana e komisionit të vlerësimit të ofertave. Jo më kot ligjvënësi, në varësi të llojit të procedurës, ka parashikuar një afat kohor (20 ose 15 ditë) për procesin e vlerësimit të ofertave duke dhënë garanci për secilën prej palëve, KVO nga njëra anë për kryerjen e një vlerësimi të thelluar e transparent dhe me mundësinë edhe të kryerjes së verifikimeve pranë palëve të treta ose sqarimeve nga operatorët ekonomikë sa herë lind nevoja, dhe operatorëve ekonomikë pjesëmarrës që pas procesit të vlerësimit të ofertave dhe publikimit të njoftimit të fituesit paraprak apo anulimit të procedurës të kenë mundësi të mbrojnë interesat e ligjshëm duke ushtruar të drejtën e ankimit në autoritet kontraktor dhe në KPP. Në këtë kuadër KPP gjykon, se brenda periudhës kohore që ligji parashikon, KVO e autoritetit kontraktor ka patur në dispozicion momentin procedural për kryerjen e verifikimeve apo sqarimeve të nevojshme për përmbushjen e kriterëve të përgjithshme apo të veçanta të kualifikimit, derisa të konkludonte me mbylljen e procesit të vlerësimit në sistemin e prokurimit elektronik me datë 13.03.2023, ku operatori ekonomik “Power Industries” SHPK rezultoi i kualifikuar, çfarë do të thotë, se sipas vlerësimit të KVO-së së autoritetit kontraktor “Power Industries” SHPK i ka përmbushur kriteret për kualifikim, përfshirë edhe pikën 2.3. gwrma b) dhe c) të kapacitetit teknik në kriteret e veçanta të kualifikimit. Ligjvënësi e ka parashikuar qartë në nenin 26 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, që në rastin e formularit përmbledhës të vetëdeklarimit bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla.

Për të vazhduar me pikën 6 të VKM-së së sipërcituar ku parashikohet se “6. Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin. Në këtë kuadër pas dorëzimit të dokumentacionit në formë shkresore nga operatori ekonomik i kualifikuar, i pari sipas autoritetit kontraktor (pas ankimit protokolluar pranë KPP-së nr. 619prot., datë 23.03.2023 të këtij të fundit në lidhje me kundërshtimin e kualifikimit të operatorit ekonomik “Zeqiri” SHPK) Komisioni gjykon, se vetëm për dokumentet e deklaruara në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit dhe që kanë shërbyer si provë paraprake, autoriteti kontraktor mund të shprehë vlerësimin mbi përputhshmërinë e tyre me atë që operatori ekonomik ankimues ka deklaruar në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit të ngarkuar në SPE. Ndërsa për të gjithë dokumentet e tjera të

ngarkuara në sistemin e prokurimit elektronik, KVO e autoritetit kontraktor, ka patur në dispozicion momentin procedural deri me datë 13.03.2023, kur ka përfunduar procesi i vlerësimit në SPE dhe njoftimi i operatorëve ekonomikë pjesëmarrës mbi vlerësimin për t'u shprehur në lidhje me përputhshmërinë e tyre me kriteret për kualifikim të përcaktuara në dokumentet e tenderit. Legjislacioni i prokurimit publik e përcakton në mënyrë të qartë që një ofertë konsiderohet e vlefshme vetëm nëse ajo pëmbush të gjitha kërkesat për kualifikim, fakt të cilin KVO e autoritetit kontraktor e ka shprehur me vlerësimin e datës 13.03.2023, ku operatori ekonomik "Power Industries" SHPK rezulton i kualifikuar. KPP gjykon, se ligjvënësi ka përcaktuar një procedurë të caktuar për t'u ndjekur nga ana e autoriteteve kontraktore në procesin e vlerësimit të ofertave dhe vetëm në rastet e deklarimeve të paraqitura në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit të ngarkuar në SPE dhe që shërbejnë si provë paraprake vlerësimi, KVO e autoritetit kontraktor me dokumentacionin e dorëzuar në rrugë shkesore mund të verifikojë përputhshmërinë e deklarimeve të paraqitura në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit dhe dokumentacionit të dorëzuar në rrugë shkresore. Ndërsa në rastin konkret për përmbushjen e pikës 2.3. gërma b) dhe c) të kapacitetit teknik, në kriteret e veçanta të kualifikimit KPP vëren, se duhet të ishte data 13.03.2023 kur rezulton të jetë mbyllur edhe procesi i vlerësimit të ofertave nga KVO dhe ku operatori ekonomik "Power Industries" SHPK rezulton të jetë i kualifikuar. KPP e gjykon të gabuar, si zbatimin ashtu dhe interpretimin e ligjit në rastin konkret nga ana e autoritetit kontraktor, pasi në respektim të dispozitave të sipërcituara autoriteti pas përfundimit të vlerësimit të ofertave dhe dërgimit të klasifikimit përfundimtar operatorëve ekonomikë pjesëmarrës duhej t'i kërkonte ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat "a", "b", "d", "dh", "e", "h", "i", "j" të pikës 2 të nenit 26 të VKM nr. 285, datë 19.02.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike, por që nuk mund të rivlerësonte edhe njëherë dokumentet e dorëzuara në rrugë elektronike me qëllim verifikimin e përmbushjes së kriterëve për kualifikim, pasi për këtë fakt KVO e autoriteti kontraktor ishte shprehur njëherë me datë 13.03.2023 dhe ku statusi i operatorit ekonomik "Power Industries" SHPK rezultonte i kualifikuar. Komisioni i Prokurimit Publik thekson faktin, se përcaktimi i procedurave dhe afateve të caktuara procedurale në LLP dhe Rregullat e Prokurimit Publik, duke filluar nga afati për përgatitjen e ofertës, afati i shqyrtimit të ofertave, afati i ankimimit etj, përfaqësojnë garanci dhe siguri juridike për palët e interesuara. Parimi i ligjshmërisë është ndër parimet kryesore të veprimtarisë së organeve të administratës publike. Gjithashtu, ndër parimet kryesore të zhvillimit të procedurave të prokurimit, parashikuar nga *lex specialis* LPP, në nenin 2 të tij, janë ato të mosdiskriminimit, transparencës dhe barazisë. Tërësia e elementeve të mësipërme lidhet ngushtësisht me elemente të ligjshmërisë së vendimeve të organeve të administratës publike. Gjithashtu KPP gjykon, se ligjvënësi ka parashikuar afate strikte kohore për zhvillimin e procedurave të prokurimit në përgjithësi dhe në veçanti në lidhje me institutin e ankimit administrativ, të rishikimit të vendimmarrjes së autoritetit kontraktor. KPP gjykon, se autoriteti kontraktor ka gabuar në zbatimin dhe interpretimin e ligjit në rastin konkret, pasi nuk ka marrë parasysh ndryshimet ligjore në lidhje me nenin 26 të VKM nr.285

datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik, ku parashikohet shprehimisht se Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin. Vendimi i Komisionit të Vlerësimit të Ofertave i datës 16.05.2023 mbi skualifikimin e operatorit ekonomik “Power Industries” SHPK, si dhe vendimi për vijimin e hapave të mëtejshëm të procedurës së prokurimit në lidhje me publikimin e aktit administrativ të njoftim-anulimit të procedurës më datë 03.05.2023, janë akte administrativ në kuptim të nenit 3 pika 1 të K.Pr.A, (ligji 44/2015) “si çdo shprehje e vullnetit nga organi publik, në ushtrimin e funksionit të tij publik, kundrejt një apo më shumë subjektsh të përcaktuara individualisht të së drejtës, i cili krijon, ndryshon ose shuan një marrëdhënie juridike konkrete”. Sa më sipër, Komisioni i Prokurimit Publik konstaton, se akti administrativ i KVO-së i datës 16.05.2023 në lidhje me skualifikimin e operatorit ekonomik ankimues “Power Industries” SHPK dhe akti administrativ për vijimin e hapave të mëtejshëm të procedurës së prokurimit, pra publikimit të njoftimit të anulimit, do të konsiderohen si akte absolutisht të pavlefshme, pasi skualifikimi i operatorit ekonomik ankimues pas dorëzimit të dokumentacionit në rrugë shkresore në autoritet kontraktor për mospërmbushjen e një kriteri për të cilin me dokumentacionin e ngarkuar në sistem dhe sipas vlerësimit të kryer me datë 13.03.2023 nga ana e autoritetit kontraktor rezultonte si i përmbushur, e bën atë absolutisht të pavlefshëm si veprim procedural. Në nenin 108 të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, parashikon se “Akti administrativ është absolutisht i pavlefshëm në rastet e mëposhtme: a) kur vjen në kundërshtim të hapur dhe flagrant me një dispozitë urdhëruese të këtij Kodi dhe legjislacionit në fuqi lidhur me: i) kompetencën e organit publik; ii) procedurën e nxjerrjes së tij; ose iii) formën ose elementë të tjerë të detyrueshëm të aktit; b) është nxjerrë nëpërmjet mashtrimit, kanosjes, mitmarrjes, konfliktit të interesit, falsifikimit apo një veprimi tjetër që përbën vepër penale; c) ekzekutimi i aktit mund të shkaktojë një veprim të dënueshëm, sipas legjislacionit penal; ç) në çdo rast tjetër të parashikuar shprehimisht në ligj.” Gjithashtu, në nenin 111 të K.Pr.A parashikohet se “Organi publik ka detyrimin të konstatojë pavlefshmërinë absolute të aktit administrativ nëse vjen në dijeni për rastet e parashikuara në nenin 108 të këtij Kodi”. Ndër karakteristikat thelbësore të veprimit juridik absolutisht të pavlefshëm përmendim: (i) veprimi juridik që është absolutisht i pavlefshëm nuk shkakton pasojat juridike që synojnë palët; (ii) ai nuk ka fuqinë juridike të një veprimi juridik të vlefshëm; (iv) veprimi juridik i pavlefshëm nuk mund të bëhet i vlefshëm me asnjë veprim të mëpasshëm, as edhe kur ekziston vullneti i palëve (me aprovim, miratim), as me kalimin e kohës së parashkrimit dhe as me zhdukjen më vonë të shkakut të pavlefshmërisë (quod ab initio vitiosum est tractu temporis convalescere non potest). Komisioni i Prokurimit Publik në interpretim sistematik (domethënien e drejtë të normës juridike, duke e vënë në lidhmëri me normat e tjera brenda sistemit juridik), gjykon, se ndodhet para kushtit të konstatimit prima facia të një akti administrativ absolutisht të pavlefshëm dhe në cilësinë e organit administrativ më të

lantë në fushën e prokurimeve, që shqyrton ankesat për procedurat e prokurimit, parashikuar nga neni 24/1 i ligjit nr. 162 datë 23.12.2020 “*Për prokurimin publik*”, konstaton se akti administrativ i Komisionit Vlerësimit të Ofertave për skualifikimin e operatorit ekonomik ankimues “Power Industries” SHPK, dhe publikimi i njoftimit të anulimit i datës 16.05.2023 të procedurës së prokurimit objekt-ankimi nga autoriteti kontraktor, janë akte administrative absolutisht të pavlefshme në kuptim të nenit 108 të K.Pr.A. Sa më sipër, referuar nenit 110 të KPrA në të cilën parashikohet se “*Akti administrativ absolutisht i pavlefshëm nuk sjell asnjë pasojë juridike, pavarësisht faktit nëse është konstatuar apo jo si i tillë. Ai konsiderohet se nuk ekziston.*”, autoriteti kontraktor duhet të marrë masat për kthimin e situatës juridike në gjendjen fillestare për operatorin ekonomik ankimues “Power Industries” SHPK. Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se hapat proceduralë të ndjekur nga autoriteti kontraktor për procedurën e prokurimit objekt-prokurimi cenojnë në thelb jo vetëm garancitë procedurale të operatorëve ekonomikë pjesëmarrës, por njëherazi cenojnë edhe parimin e sigurisë juridike. Në jurisprudencën e saj *Inter Allia*, Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë në vendimin nr. 12/2014 datë 17.03.2014 është shprehur se “*Siguria juridike nënkupton, ndërmjet të tjerash, garantimin e besueshmërisë së individit tek shteti, institucionet e tij dhe tek aktet që ato nxjerrin*”. Sa më sipër, KPP gjykon, se në rastin konkret parimi i sigurisë juridike në kuptimin material të tij, konsiderohet edhe moscenimi i të drejtave të fituara dhe i pritshmërive të ligjshme që garantojnë aktet në fuqi. Akoma më tej, në jurisprudencën e saj, Gjykata Kushtetuese *Inter Allia* në vendimin 15/2010 ka theksuar se “*parimi i shtetit të së drejtës i sanksionuar në nenin 4 të Kushtetutës nënkupton veprimin e të gjithë institucioneve shtetërore sipas së drejtës në fuqi si dhe supremacinë e Kushtetutës ndaj akteve të tjera normative. Çdo organ në një shtet të së drejtës duhet të veprojë për atë që i lejon Kushtetuta dhe ligji duke mos i tejkaluar kufijtë e përcaktuar prej tyre. Në këtë kuptim, çdo institucion shtetëror duhet të ketë të përcaktuar qartë fushën e kompetencave të veta brenda të cilave është i autorizuar të veprojë në përputhje me kërkesat kushtetuese dhe ligjore*”. Sa më sipër, K.P.P. konstaton, se vendimi i Komisionit Vlerësimit të Ofertave i datës 16.05.2023 dhe vendimi i KSHA me nr. 28/17 prot., datë 02.06.2023, mbi shyrtingun e ankesës së operatorit ekonomik ankimues “Power Industries” SHPK, si një akt administrativ individual, i shtrin efektet *inter parties* dhe në asnjë rast *erga omnes*. Ndaj KPP, gjykon, se këto vendime janë në kundërshtim me hapat proceduralë që parashikon LPP, ndaj këto vendime duhet të anulohen si vendime të dala në kundërshtim me ligjin për prokurimin publik.

Sa më sipër, KPP gjykon, se skualifikimi i operatorit ekonomik ankimues “Power Industries” SHPK është kryer në shkelje të parashikimeve ligjore dhe KPP i tërheq vëmendjen autoritetit kontraktor, për mosrespektim të dispozitave ligjore në fuqi, lidhur me momentin procedural të verifikimit të dokumentacionit original në shkelje të afateve ligjore. KPP gjykon, se autoriteti kontraktor për procedurat e prokurimit të cilat realizon, duhet të garantojë respektimin e parashikimeve ligjore në fuqi dhe parimeve të transparencës dhe efikasitetit parashikuar në nenin 2 të LPP-së. Në këtë kuptim, KPP e gjen skualifikimin e operatorit ekonomik ankimues, të papabazuar në ligj dhe në kapërcim të afateve ligjore në fuqi.

Për sa më sipër, pretendimi i operatorit ekonomik ankimues “Power Industries” SHPK qëndron.

Për sa më sipër, në mbështetje të neneve 30, dhe 118 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 236, datë 20.04.2023 “Për përcaktimin e rregullave dhe tarifës së pagesës për ankim në një procedurë prokurimi, pranë Komisionit të Prokurimit Publik”, Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766/2021, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funkcionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri

Vendos:

1. Të pranojë ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “Power Industries” SHPK SHPK, për procedurën e prokurimit “Procedurë e hapur”, me Nr. REF-58081-02-06-2023, me objekt: “Blerje Kazane për mbetje urbane” me fond limit 29.869.700 (Njëzet e nëntë milion e tetëqind e gjashtëdhjetë e nëntë mijë e shtatëqind) lekë pa TVSH, zhvilluar me datë 01.03.2023 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Durrës.
2. Autoriteti kontraktor të anulojë vendimin e KVO-së mbi skualifikimin e operatorit ekonomik “Power Industries” SHPK, si dhe të korrigojë shkeljet, duke e kualifikuar këtë operator.
3. Autoriteti kontraktor të anulojë vendimin mbi anulimin e procedurës.
4. Autoriteti kontraktor brenda 5 ditëve të vëre në dijëni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e vendimit, duke dokumentuar veprimet e kryera.
5. Ngarkohet zyra e financës që të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “Power Industries” SHPK.
6. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nënkryetar
Fiorent Zguro

Anëtar
Anila Malaj

Anëtar
Kreshnik Ternova

Kryetar
Jonaid Myzyri